

REDAKSIA

Kryeredaktorë:

Zana Buçinca
Blerina Zhitija

Redaktorë përgjegjës:

Arrita Rezniaqi
Rozafa Maliqi
Rudina Morina

Disejmi:

Zana Buçinca

Anëtarë të redaksisë:

Andi Selimi
Bardha Çollaku
Donika Kryeziu
Diellza Dobroshi
Diora Binxhiu
Gentiana Demaj
Leonora Beqiri
Luljeta Krasniqi
Njomëza Beqiri
Rineta Zeka
Zana Beqa
Xheva Govori

Organizimi i klasave te ulëta

Përveç organizimit të mësimit në klasë, rol të rëndësishëm në procesin edukativo-arsimor luajnë edhe aktivitetet e lira që zhvillohen në shkollë dhe jashtë saj.

Sipas mënyrës së planifikimit të mësimit, planifikim tematik, realizohen edhe vizitat jashtë shkollës me qëllim që nxënësit të njihen më drejtpërdrejt me përmbajtjet e shtjelluara në klasë. Në kuadër të aktiveve janë realizuar disa vizita:

Klasat e dyta:

Më 1.2.2008 u realizuan vizitat në Stacionin e autobusëve ne Prishtinë dhe Stacionin e trenit në Fushë Kosovë. Me këtë rast vizituan edhe muzeun e hekurudhave të Kosovës në Fushë Kosovë.

Më 8.2.2008 u bë vizita në teatrin Dodona, me ç'rast përcollën shfaqjen teatrale "Kësulëkuaja".
Më 27-28.2.2008 me rastin e Pavarësisë së Kosovës u realizuan vizita në institucionet e Kosovës. Në Presidencë te presidenti i Republikës së Kosovës z. Fatmir Sejdiu, në Kryeministri te kryeministri z. Hashim Thaçit dhe në komunën e Prishtinës te kryetari z. Isa Mustafa.

Më 3. 3. 2008 nxënësit e klasave të treta shkuan në Spitalin e Ortopedisë me qëllim të njohjes me ambientin dhe punën që bëhet aty. Vizitën e mundësoi prindi Cen Bytyçi - doktor.



Mësim në natyrë

Klasat e pesta, të gjashta, të shtata dhe të teta të shkollës sonë zhvilluan mësim në natyrë. Dy orët e para u mbajtën në shkollë dhe më pas u nisën në Gërmi. Fillimisht, klasat e 8-ta, luajtën një lojë me arsimtaren Fitore, Vjosa dhe arsimtarin Fatmir. Rregullat e lojës u zhvilluan në atë mënyrë që nxënësit u ndanë në tri grupe dhe arsimtarët udhëzuan secilin grup me nga një letër ku ishin të shkruara rregullat e lojës. Për shembull anëtarët e një grupi duheshin t'i përgjigjeshin më zë të ulët pyetjes së anëtarit të grupit tjetër. Secili grup i mësoi rregullat e veta dhe vazhduan lojën. Më vonë shkuan më lart, në hapësirat pyjore me arsimtaren e biologjisë për të folur për ekosistemet pyjore. Arsimtarja Arta shpjegoi për shkallën e dëmtimit të pyjeve duke treguar shembuj të drurëve dhe shkallën e dëmtimit të tyre. Nxënësit po ashtu mësuuan se pylli që po vizitonin ishte monokulturë, sepse në të rritej vetëm një lloj druri. Përmendën edhe disa bimë karakteristike dhe analizuan kushtet klimatike të Gërmisë. Po ashtu patën rastin të shihnin shembuj të stelave pyjore që tashmë kishin mësuar për to. Pas kësaj u kthyen në fushën e sportit, ku arsimtari i edukatës fizike Driton Mamaj ndau ekipet sipas gjeneratave, që të luanim futboll dhe basketboll. Pak më vonë arsimtarët shpërndanë drekën. Pas drekës nxënësit u përgatitën për t'u kthyer në shtëpi në një atmosferë gëzimi.



Zbukurimi i shkollës me lule

Në fillim të këtij gjysmëvjetori u ndërmor një aksion nga ekologët e rinj. Qëllimi i këtij aksioni ishte mbledhja e një shume simbolike të hollash nga të gjitha klasat, me qëllim që shkolla jonë, edhe pse e madhe shumë, të mbushet e tëra me lule. Këtë aksion e ndihmoi drejtorja e shkollës e cila dha kontributin e saj të mjaftueshëm, në mënyrë që shkolla të marrë një pamje sa më të bukur.

Lulet tani kanë vendet e tyre në korridoret dhe klasat e shkollës sonë. Çdo klasë ka lulet për të cilat nxënësit tregojnë kujdes të madh, sidomos ekologët e rinj të cilët ujin këto lule në kuadër të aktiviteteve të tyre.



Dita e qumështit

Vizita në qumështoren “Bylmeti”

Me qëllim që nxënësit të kuptojnë dhe të shënojnë datat e rëndësishme ndërkombëtare, më 29 shkurt, për nder të ditës së qumështit në të gjitha lëndët, në mënyra të ndryshme, u vendos që të flitet dhe të mësohet më shumë për qumështin. Nxënësit morën informacione të ndryshme për rëndësinë e qumështit të nënës dhe produktet e qumështit nga kafshë të ndryshme. Në lëndën e gjuhës shqipe nxënësit arritën të improvizojnë disa skeçe, të cilat dolën shumë interesante dhe njëra nga to ishte kur ata u vunë në pozitë të prodhimeve të qumështit duke u shtyrë se cila nga këto prodhime është më e mira. U mbajt edhe një ligjëratë nga prindi Bajram Abdullahu, doktor i alergjisë, i cili foli për rëndësinë e qumështit në përgjithësi dhe për mundësitë e rrugët e alergjisë nga qumështi. Një aktivitet tjetër që shoqëroi këtë ditë ishte edhe vizita në qumështoren “Bylmeti”, vizitë e cila mundësoi që nxënësit e klasave të teta të njoheshin me prodhimet, përpunimin, paketimin dhe me shpërndarjen e qumështit. Njëri nga punëtorët e kësaj qumështoreje shpjegoi të gjitha proceset në të cilat kalon qumështi. Pastaj së fundi, nxënësit morën si dhuratë nga një pako qumështi si shenjë falënderimi për vizitën.



Vizitë Toenës

Çdo muaj nxënësit e klasave të ndryshme lexojnë nga një vepër letrare, referatin e së cilës e bëjnë në fund të muajit. Veprat përzgjidhen nga arsimtarët e gjuhës shqipe në bashkëpunim me nxënësit. Veprat e përzgjedhura janë me tematikë të ndryshme dhe lidhen me moshën e nxënësve. Në fund të muajit ata mbledhen në “tryezën e rumbullakët” dhe diskutojnë, analizojnë e interpretojnë veprën të cilën e kanë lexuar. Arsimtarët e gjuhës shqipe duke e parë interesimin e nxënësve për lexim, organizuan një vizitë për nxënësit në librarinë “Artini”- botimet Toena. Nxënësit shfletuan titujt e ndryshëm të veprave letrare të moshës së tyre dhe blenë disa nga ato që u pëlqyen më së shumti. Kjo vizitë u organizua me qëllim që nxënësit të afrohen sa më shumë me botën e librit.



Valsi i Pavarësisë

Dita e madhe e Pavarësisë u shënua edhe në Mileniumin e Tretë. E nisur me vjersha për Pavarësinë, e pasqyruar me vizatime e piktura nga nxënësit e klasave të ulëta e të larta, kjo festë madhështore, u kurorëzua më pas me organizimin e një programi festiv të pagëzuar "Valsi i Pavarësisë" i cili u vendos që të jetë tradicional. Festa filloi, kur grupi i vajzave të vallëzimit modern "Flokëgjatat", nga klasat e pesta, ngjallën atmosferën, në fushën e sportit, për të vazhduar me vallen shqiptare Shota të luajtur po ashtu nga nxënësit e klasave të pesta, e cila ishte mbresëlënëse. Për të shënuar sa më mirë këtë ditë dolën në skenë çiftet e nxënësve nga klasat e gjashta, shtata dhe të teta, të cilët ishin përgatitur që sa kohë, me ndihmën e arsimtarit të Edukatës fizike Driton Mamaj, për të dalë sa më mirë me paraqitjet e tyre në ekzekutimin e pikave në vals. Enkas për të bërë përzgjedhjen e tri çifteve finaliste ishte ngritur një komision profesional në përbërje të arsimtarëve, të cilët pas vallëzimit të bukur të nxënësve dhanë vlerësimin e tyre. Përgëzimin për nxënësit me mirënjohje, diploma e shpërblime e bënë drejtoresha Afrone Lila dhe kryetarja e komisionit, mësuesja Zana Zeqiri. Fituesit e Valsit të Pavarësisë ishin:

1. Fjoralba Krapi dhe Ilir Selmani
2. Ema Smajli dhe Arian Selmani
3. Zana Buçinca dhe Arian Dalladaku



Pjesëmarrja e prindërve në procesin mësimor


29. 2. 2008 – Prindi Valbona Stavileci prezantoi para nxënësve të klasave të treta temën **Trupi i njeriut**, temë e cila ka qenë edhe tema mujore e punës së nxënësve në klasë. Përveç prezantimit u realizua edhe një kuiz po me të njëjtën temë.

Aktivitetet e lira

Aktivitetet e lira realizohen në mënyrë të organizuar ku nxënësit kanë mundësi të shfaqin talentin e tyre në fusha të ndryshme. Në kuadër të tyre ekzistojnë gjashtë grupe: Grupi i dramës, i leximit, i artit, i sportit, i informatikës dhe i vallëzimit. Këto aktivitete mbahen dy herë gjatë javës.

“Ëndrra e një nate vere” nga Shekspiri

Edhe në shkollën tonë Festa e Mësuesit 7 Marsi dhe Festa e Nënës 8 Marsi na gjeti të gatshëm për t'u dhuruar mësuesve, arsimtarëve tanë një shfaqje të bukur teatrale. Me vullnet, dëshirë dhe përkushtim të madh arritëm ta vëmë në skenë tekstin e Shekspirit “Ëndërr e një nate vere”. Ndonëse një tekst i pakapshëm me leximin e parë, dëshira që këtë kryevepër ta luajmë, mposhti çdo pengesë tjetër. Për dy ditë feste radhazi, këtë shfaqje e shfaqëm para nxënësve, jo vetëm të shkollës sonë, profesionistëve dhe prindërve të shumtë në teatrin “Dodona”. Na përgëzuan shumë për rolet tona (për rolet të cilat na ndihmoi jashtëzakonisht ars. Elikona Hysaj), por gjithsesi edhe për skenografinë, për të cilën jemi kujdesur vetë në nxënësit, (me ndihmën e arsimtares së palodhshme Mirlinda Ramadani) duke e pikturuar një tablo të bukur peizazhi vere. Përveç që kishim përgatitur skenën, kishim edhe kostumet interesante, të cilat ia dhanë madhështinë roleve tona. Ishte një gëzim i madh për neve, pasi me entuziazmin e shfaqjes, gëzimin që e kishim në zemër përqaftim arsimtarët tanë, (në veçanti arsimtaren Indira Ibrani për organizimin e dramës) duke ua uruar këto dy festa. Gjithashtu u lexuan shumë poezi kushtuar pikërisht këtyre dy festave, sidomos nga fëmijët e ciklit të ulët shkollor.

**Muzeu etnografik**

Nxënësit e shkollës jopublike “Mileniumi i Tretë” për herë të tretë vizituan muzeun etnografik të Kosovës. Kësaj radhe, pos të tjerash, ata u njoftuan më shumë me punën e qeleshepunuesve dhe biseduan me një qeleshepunues, i cili shpjegoi procedurat në të cilat kalon plisi derisa merr formën përfundimtare. Gjithashtu ata u njohën edhe me shumë zakone e tradita të shqiptarëve. Gdhendja e zburimeve në dru ishte një befasi e këndshme për ta. Teksa shihnin ato figura të mahnitshme të gdhendura në dru ata po afroreshin gjithnjë e më shumë me kulturën shqiptare. Dhe në fakt, ky ishte edhe qëllimi i vizitës. Pastaj pasoi edhe vizita e bërë odës së burrave, dhomës së pajës, dhomës së vdekjes, etj. Ciceroni i njoftoi ata edhe me ritualet e lindjes, martesës dhe vdekjes. Të kënaqur me atë që arritën të mësonin, nxënësit u larguan nga muzeu me një përshtypje të jashtëzakonshme.

